



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:029901
Datë: 12.03.2024
Numri i dokumentit: 05439479

C-IV-14-3039

Ankuesi

S J, fshati R, Prizren.

Përfaqësuar nga avokat B I Prishtinë.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Driton Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 07 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- APROVOHET** ankesa si e bazuar dhe **NDRYSHOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së PRZ017-0004/0204 datë 10 mars 2014.
- OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit **S J** në emër të kompensimit për paga të papaguara periudhën prej 01 korrik 1999 deri më 19 dhjetor 2005, t’i paguaj **shumën prej 185.00 €**, si dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t’i paguaj **shumën prej 18.50 €**.
- Shumat e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.
- OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës **në shumë prej 104.00 €**.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 18 prill 2014, ankuesi (nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar) dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. PRZ017-0004/0204 datë 10 mars 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa për kompensim për paga të papaguara për periudhën prej 01 korrik 1999 deri më 19 dhjetor 2005 në shumë prej 185.00 € nga NSH “NIN Ramiz Sadiku” (në likuidim). Ankuesi pohoi se NSH “Ramiz Sadiku” Prizren është ndërmarrje

shoqërore e cila u privatizua me 24 mars 2006. Ankuesi në këtë rast ishte punëtor i ndërmarrjes dhe të njëjtën datë Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) i ndërpreu atij kontratën e punës. Ankuesi kishte paraqitur kërkesë me kohë ndaj AL të AKP-së për paga të papaguara, mirëpo e njëjta ia refuzoi kërkesën e tij si të parashkruar. Në kohën kur këtij punëtorit iu ndërpre marrëdhënia e punës, ligjet e aplikueshme të punës ishin Rregulloret e UNMIK-ut 2001/27 dhe 2005/48. Pastaj më vonë me 15 nëntor 2010 u aprovua Ligji i Ri i Punës (Ligji Nr.03/L-212) por pa ndryshime esenciale siç u miratua edhe Ligji i AKP-së, por po ashtu pa ndryshime në këtë çështje. Ankuesit edhe punëtorëve e tjerë u është ndërprerë në mënyrë masive kontrata e punës nga ndërmarrja. Rrjedhimisht të gjithë ata kanë të drejtë në paga të papaguara. AKP-ja nuk ua kishte mohuar këtë. AKP-ja kishte refuzuar këto kërkesa duke pretenduar se kërkesa e tij për paga të papaguara është e parashkruar. Siç shihet edhe nga lista e pagave të nënshkruara, ato janë përgatitur edhe nënshkruar dy herë dhe atë në një listë përmbledhëse (01 korrik 1999- 19 dhjetor 2005) dhe për secilin muaj veç e veç duke filluar nga muaji prill deri më 19 janar 2006. Punëtori evidentohet në listën përmbledhëse të pagave nën numrin rendor 204 dhe në listat mujore nga muaji prill 2002 deri më 19 janar 2006. Përfaqësuesi i autorizuar theksoi se vendimet e AL janë një lloj formulari – modeli i shumëzuar në qindra kopje, nuk janë të arsyetuara edhe pse sipas ligjit arsyetimi i vendimit është i obliguar. Duke mos pasur këtë arsyetim është e pamundur të kuptohet se çka është kontestuar dhe nga cila bazë është kontestuar kërkesa e palës. Rezultati i kësaj praktike është pengimi dhe krijimi i shumë vështirësive të punëtorëve që ti realizojnë të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë të Kosovës me konventa ndërkombëtare dhe Ligjin e AKP-së. Më tej theksoi se Ligji i Punës së Bashkuar (LPB) nuk është ligj në fuqi në Kosovë që nga viti 1989. Ky ligj ishte publikuar në GZ të RSFJ-së nr.53/76 të vitit 1976 (me ndryshimet e më vonshme) mirëpo ai nuk është ligj në fuqi në Kosovë dhe atë që nga hyrja në fuqi e Ligjit mbi Ndërmarrjet, shih nenin 196 GZ e RSFJ nr.77/88 i cili e ka shfuqizuar këtë ligj, duke përfshirë edhe nenin 608 i cili sipas AKP-së është bazë juridike me të cilën janë refuzuar kërkesat e punëtorëve. Neni 196 par. 1 thotë: “Ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji pushon së vepruari LPB, (par.2 pastaj lejon zbatimin e dispozitave të LPB që nuk janë në kundërshtim me Ligjin mbi ndërmarrjet) pastaj neni 197 i po këtij ligji thotë “...ky ligj ka hyrë në fuqi me 01 janar 1989”. Edhe sikur të ishte në fuqi neni 608 i LPB-së përsëri nuk do të mund të kishte parashkrim sepse shkaktar i vetëm i saj do të ishte AL – AKP që nuk i ka përmbushur detyrimet e pagesës me kohë prandaj do të ishte e papranueshme që kjo e drejtë e themeluar me ligj ti mohohet punëtorit për shkak të vonesës së AL. Punëtorëve kurdoherë që ata kanë kërkuar sqarime u është thënë se të gjitha kërkesat duhet ti paraqesin vetëm pas shpalljes së likuidimit ashtu që ata e kanë kuptuar se nuk mundën dhe nuk duhet të bëhet asgjë deri në ditën e shpalljes së likuidimit. Me rastin e shpalljes së likuidimit AKP-ja tërheq gjithë arkivën e dokumentacionit të NSH-së në zyret e saj dhe atë më nuk e përdor me rastin e shqyrtimit të kërkesave të kreditorëve por kërkon që secili kreditor në rastin tonë secili punëtor ti prezantoj asaj të gjitha dokumentet duke përfshirë këtu edhe vet dokumentet e NSH-ve dhe të AKP-së e që në shumicën e rasteve nuk është i njohur për punëtorin. Njohja e të drejtës së punëtorit në 20% është dëshmi e mjaftueshme se punëtori ka qenë në marrëdhënie punë deri në ditën e privatizimit, pra edhe në listën e pagave prandaj i njëjti titullar (AKP-ja) nuk mundet që statusin e punëtorit ta trajtoj në dy mënyra të ndryshme (ta pranoj – njoh për 20% dhe ta mohoj për paga). Rregulloret e UNMIK-ut: 2001/27 dhe 2005/48, Ligji i AKP-së si dhe Ligji i Punës i Kosovës në mënyrë të qartë u japin të drejtë punëtorëve në paga të papaguara. Ankuesi ishte në marrëdhënie pune të përhershme në NSH-në në fjalë dhe në

aspektin ekonomik ishte i varur nga kjo punë dhe kishte punuar gjatë në këtë NSH dhe ai ka paga të papaguara. Ky borxh i NSH-së ndaj këtij punëtori nuk ishte mohuar as nga vet NSH-ja. Pra, ankuesi i përmbush këto kushte në tërësi e që janë bazë themelore për paga të papaguara. Ligjet e aplikueshme të Kosovës për marrëdhëniet e punës si dhe ligjet për privatizimin, të gjitha këto ligje në mënyrë të qartë i japin të drejtën ankuesit / punëtorit të NSH-së në paga të papaguara sipas ligjeve të aplikueshme të punës dhe ligjeve për privatizimin, kërkesa e ankuesit të NSH-së nuk është parashkruar por është e vlefshme. Ankuesi i propozon gjykatës që të anulohet vendimi dhe të paditurës dhe t'a urdhëroj AL-në që të miratojë kërkesën e tij në shumën e përcaktuar në vendimin e AL dhe 10 %. Në mbështetje të ankesës së tij ka bashkangjitur në kopje dëshmitë si: Letërnjoftimin, prokurën speciale dhe vendimin e kundërshtuar.

Me 01 nëntor 2014, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, pohoi se i përmbahet qëndrimit se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. Ankesa është parashtruar nga parashtruesi nuk ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë siç parashihen nga neni 74.2 i Ligjit 06/L-086. E paditura konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e vendimit të AL. Në këtë kontekst, 14.2 i Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur Nenin 74.2 të Ligjit 06/L-086 i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Prandaj, në pajtim me qëndrimin e vet parashtruesit, vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit 04/L-034 dhe prandaj nuk ka bazë ligjore për të shfuqizuar vendimin. Rrjedhimisht, në zbatim të Nenit 74.2 të Ligjit 06/L-086 ankesa në fjalë është e pabazuar. Neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr./L-034 për AKP-në parashikon: “...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme për refuzim të Kërkesës apo interesit të pretenduar të kapitalit apo interesit të pronësisë:...Kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm nga kufizimet kohore të aplikueshme”. Neni 608 i LPB (publikuar në GZ Nr.53 të vitit 1976) i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24, parashikon se “pagesa e shumës së pagës apo rrogës, ose të ndonjë kërkesë tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet”. Në bazë të dispozitave të mësipërme, kërkesa duhet të jetë paraqitur në gjyq apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre viteve nga momenti kur NSH-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit, konkretisht më së voni deri më 01 korrik 2002. Prandaj, AL refuzon këtë kërkesë si të pavlefshme. E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar si dhe të vërtetojë vendimet e AL në pajtim me nenin 74.2 të Ligjit 06/L-086. E paditura në mbështetje të mbrojtjes së saj ka bashkangjitur vetëm Vendimin e kundërshtuar.

Me 12 janar 2024, përfaqësuesi i autorizuar i ankuesit duke vepruar sipas urdhrorit të gjykatës të datës 20 dhjetor 2023, dorëzoi një përgjigje përmes së cilës kërkoi që të miratohet ankesa e ankuesit si e bazuar dhe të shfuqizohet vendimi i kundërshtuar si dhe të detyrohet e paditura që

në emër të kompensimit për pagat e papaguara prej datës 01 korrik 1999 deri më 19 dhjetor 2005, t'i paguaj shumën e përgjithshme prej 185.00 €, duke përfshirë edhe kamatën e kalkuluar sipas nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së dhe kamatë vonesën sipas ligjit në fuqi dhe të detyrohet e paditura që të bëj kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në bazë të tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës. Në mbështetje të kësaj përgjigjeje i njëjti dorëzoi dëshmitë në kopje si: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit lëshuar për ankuesin nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) datë 21 shkurt 2006, Librezën e tij të punës nr. serik 93126 dhe Listën e të ardhurave personale të papaguara të punëtorëve të NIN “Ramiz Sadiku” në Prizren për periudhën prej 01 korrik 1999 – 19 dhjetor 2005.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrirat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuara), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Neni 14.1 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës) parasheh që: “Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës”. Neni 55.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit) parasheh që: “I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit” .

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH “NIN Ramiz Sadiku”. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja se a ka ofruar shërbime pune ankuesi dhe a i ka mbetur NSH borxh pagat për periudhën 01 korrik 1999 – 19 dhjetor 2005. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se kërkesa e ankuesit për kompensimin e pagave të papaguara është parashkruar, ndërsa ankuesi pretendon se kërkesa e tij është e ligjshme dhe e njëjta nuk është e parashkruar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij ndër të tjera e mbështet në: Njoftimin për Përfundimin e Punësimit drejtuar ankuesit lëshuar nga AKM datë 21 shkurt 2006, Librezën e tij të punës, Listën e të ardhurave personale të papaguara të punëtorëve të NIN “Ramiz Sadiku” në Prizren për periudhën prej 01 korrik 1999 – 19 dhjetor 2005, si dhe në pohimet e parashtruara në ankesë.

Nga librezja e tij e punës dhe njoftimi për përfundimin e punësimit, i datës 21 shkurt 2006, i dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH “NIN Ramiz Sadiku” deri me 21 shkurt 2006, kohë edhe kur shumica (apo të gjitha) asetet e NSH-së janë shitur dhe si pasojë marrëdhënia e punës së ankuesit ka pushuar.

Nga lista e pagave të papaguara për periudhën 1 korrik 1999 – 19 dhjetor 2005, vërtetohet fakti se ankuesi kishte punuar dhe se NSH-ja i kishte mbetur borxh ankuesit shumë bruto prej 185.00 € në emër të pagave të papaguara për periudhën objekt kontesti (nr. rendor 204).

Nisur nga kjo gjendje, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, Njoftimin për përfundimin e punësimit, lëshuar me 21 shkurt 2006 nga AKM, librezën e tij të punës dhe Listën e pagave të papaguara për periudhën objekt kontesti, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën e lartcekur dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se NSH nuk i ka mbetur borxh pagat, ashtu siç ka pretenduar ankuesi. Meqenëse e paditura nuk e ka kontestuar periudhën kohore të pagave të papaguara dhe as lartësinë apo shumën totale të pagave të papaguara të kërkuara nga ankuesi, si dhe nuk ka ofruar asnjë provë që do mund të rrëzonin pretendimet e ankuesit, gjykata e aprovon kërkesën e tij.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Ankuesi kishte dorëzuar një kërkesë (sipas kërkesës kolektive) brenda afateve tek AL me 1 gusht 2006. Gjykata vlerëson se, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 21 shkurt 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Andaj, gjykata vie në përfundim se ankuesi kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar. Një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e fundit të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit (AC-I-20-0508, AC-I-22-0123, AC-I-22-0228).

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 18.50 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e paditura AKP si palë e pasuksesshme, obligohet ti paguaj shpenzimet e procedurës.

E paditura është obliguar ti paguaj ankuesit shpenzimet e procedurës dhe atë në bazë të rregullores së tarifës së Odës së Avokatëve, për ankesë në shumë prej 104.00 €.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar